



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

<b>DATË/A:</b>	30.10.2024	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë, Dr. Dafina Gexha-Bunjaku, zv. Ministre e Shëndetësisë	
<b>PËRMES/PREKO/ THOUGHT:</b>	Dr. Ardita Baraku, Drejtor Ekzekutiv, IKShPK Prof. Dr. Ariana Kalaveshi, Drejtoreshë e Departamentit të Epidemiologjisë, IKShPK	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Dr. Albiona Rashiti-Bytyçi, Epidemiologe, IKShPK	
<b>CC:</b>	Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm, MSh Dr. Arsim Qavdarbasha, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore, MSh	
<b>TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:</b>	Analizë e situatës epidemiologjike me COVID-19, periudha, 16.10.2024 - 29.10.2024	

I nderuar Ministër i Shëndetësisë, Dr. Arben Vitia,

E nderuar zv. Ministre e Shëndetësisë, Dr. Dafina Gexha-Bunjaku,

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur analizën e situatës epidemiologjike me COVID-19 për periudhën 16.10.2024 - 29.10.2024.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Ministria e Shëndetësisë  
INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE

## **Analizë e situatës epidemiologjike me COVID-19**

**30 tetor 2024**

## SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME COVID-19

### *Situata epidemiologjike globale*

Rastet globale: Sipas të dhënave të fundit të OBSH që nga 31 dhjetor 2019 deri 13 tetor 2024, janë raportuar gjithsej 776,618,091 raste të COVID-19 dhe 7,071,324 raste të vdekjes dhe janë administruar 13.64 miliard doza të vaksinës kundër COVID-19.

### *Situata epidemiologjike në Kosovë nga fillimi i pandemisë*

Nga data 08.02.2020 deri më 29.10.2024, u realizuan gjithsej 2,003,032 teste të rasteve të dyshimta në virusin SARS-CoV-2. Testimi është bërë me qëllim që të gjurmohen të gjitha kontaktet e rasteve të konfirmuara të cilat janë gjetur në mënyrë aktive nga ekipet e IKSHPK-së.


Me SARS-CoV-2, janë diagnostikuar gjithsej 276,164 raste ose 13.78% e mostrave të testuara. Deri më 29.10.2024, janë shëruar 272,930 raste ose 98.82% e të infektuarve, ndërsa aktualisht nuk ka raste aktive. Deri më tani, janë regjistruar gjithsej 3,233 raste të vdekjeve me një shkallë të letalitetit prej 1.17%.

### *Situata epidemiologjike në Kosovë në dy javët e fundit*

Në dy javët e fundit (16.10.2024 – 29.10.2024) janë raportuar 3 raste pozitive dhe asnjë rast i vdekjes me COVID-19.


Nga 3 rastet e raportuara gjatë kësaj periudhe kohore, sipas grup-moshave rezulton se i takojnë grup-moshave: 60-69 vjeç (2 raste) dhe 70-79 vjeç (1 rast).

**Grafikoni 1. Kumulativi i rasteve të testuara, të konfirmuara, të shëruara dhe vdekjet nga COVID-19 në 14 ditët e fundit**




Gjatë dy javëve të fundit prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas komunave rezultojnë rastet e raportuara të përkasin komunës së Gjakovës kurse edhe sipas incidencës numri më i madh i rasteve është nga raportuar nga komuna e Gjakovës.

**Grafikoni 2. Kumulativi i rasteve, Incidenca dhe vdekjet/100,000 banorë në 14 ditët e fundit**




Nga 3 rastet e raportuara gjatë kësaj periudhe kohore, sipas grup-moshave rezultojnë se grup-mosha që i përkasin këto raste është 60-69 dhe 70-79 vjeç. Edhe sipas incidencës, grup moshat më të prekura janë 60-69 dhe 70-79 vjeç.

**Grafikoni 3. Rastet dhe incidenca specifike për grup-moshë në 14 ditët e fundit**



Gjatë dy javëve të fundit prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas gjinisë rezultojnë gjinia mashkullore prezantohet me 2 raste (67%), dhe gjinia femërore me 1 rast (33%).

**Grafikoni 4. Numri i rasteve me COVID-19 sipas gjinisë në 14 ditët e fundit**




Gjatë dy javëve të fundit, sipas profesionit, rastet e konfirmuara të shprehura në përqindje janë si vijon:

- Profesionistët shëndetësor 0.00%
- Mësimdhënës 0.00%
- Policia 0.00%,
- Gardianët 0.00%
- Të burgosur 0.00%
- Zjarrfikës 0.00%
- FSK 0.00%,
- Kurse 100.0% janë raste të konfirmuara brenda familjeve dhe institucioneve publike dhe private.

Nga punëtorët shëndetësor janë:

- Mjek 0.00%
- Infermier 0.00%
- Farmacist 0.00% dhe
- Fizioterapeut 0.00%.

**Grafikoni 5. Pozitiviteti i rasteve (%) dhe numri i rasteve aktive në 14 ditët e fundit**




Gjatë dy javëve të fundit janë testuar gjithsej 222 raste të dyshimta me COVID-19 me një pozitivitet mesatar prej 2.59%. Sa i përket rasteve aktive në 14 ditët e fundit, momentalisht nuk kemi raste aktive.

## Modeli epidemiologjik i projeksionit të numrit të rasteve të pritshme ditore dhe numrit efektiv të riprodhimit deri me 04 nëntor 2024, sipas metodës R

Duke shfrytëzuar gjuhën programuese R [R version 4.3.0 (2023-04-21 ucrt)] është bërë projeksioni i situatës epidemiologjike me COVID-19 deri me 04 nëntor 2024, i cili paraqitet me ndryshime nga projeksionet e muajve të fundit. Projeksionet janë bërë përmes pakove të R dhe algoritmeve matematikor, të bazuar në parametra standard global, duke shfrytëzuar të dhënat e rasteve me COVID-19 nga data 09 shtator 2024. Pakoja e modelimit të sistemit R përdor një qasje joparametrike për të rindërtuar rastet sipas datës së infektimit në raport me datën e raportimit të rasteve. Kjo arrihet përmes një modeli gjenerues ose një llogaritje joparametrike për të vlerësuar infeksionet latente dhe më pas i merr për bazë këto infeksione dhe së bashku me rastet e raportuara krijon një model epidemiologjik parashikimi (forecasting). Parashikimi i numrit të riprodhimit bëhet sipas metodologjisë të lartëcekur, të adaptuar nga Stan dhe Abbot, duke shfrytëzuar rastet e raportuara sipas datave, kohën e vonesës së raportimit, kohën e gjenerimit si dhe parametra tjerë ndërkombëtar të COVID-19.

**Tabela 1** Vlerësimet më të fundit të numrit të rasteve të konfirmuara sipas datës së raportimit, ndryshimi i pritshëm në rastet e konfirmuara ditore, numri efektiv i riprodhimit, shkalla e rritjes dhe koha e dyfishimit

<i>Parametri i vlerësuar</i>	<b>Vlerësimi</b>
<i>Rastet e reja të konfirmuara sipas datës së raportimit</i>	2 (0 – 14)
<i>Ndryshimi i pritshëm në rastet e konfirmuara ditore</i>	Stabil dhe në rënie
<i>Numri Efektiv i Riprodhimit.</i>	0.66 (0.15 – 2.41)
<i>Shkalla e rritjes ditore</i>	-0.099 (-0.28 – 0.34)
<i>Koha e dyfishimit/përgjysmimit</i>	-7.2 (2.1 – -2.4)



**Figura 1** A) Rastet e konfirmuara sipas datës së raportimit (grafiku me bar-charts) dhe datës së parashikuar të raportimit të tyre; B) Rastet e konfirmuara sipas datës së infektimit (grafiku me bar-charts) dhe datës së tyre të parashikuar të infektimit;

*dhe C) Vlerësimi i Numrit Efektiv të Riprodhimit që ndryshon sipas kohës (shiriti më i lehtë = 20% interval i besueshëm; shiriti më i errët = intervali 50% i besueshëm, shiriti më i errët = intervali 90% i besueshëm). Këto duhet të konsiderohen vetëm tregues matematikor dhe vlerësime modeluese dhe duhet të merren në shfrytëzim për orientim në masat që parashihen të merren për të parandaluar infeksionin në popullatë dhe shpërthimet e reja të mundshme.*

Në Departamentin e Mikrobiologjisë, IKSHPK, Prishtinë, janë sekuencuar me sukses dhe analizuar gjatë javës së kaluar në total 83 mostra me SARS-CoV-2 të mbledhura nga rastet pozitive në SARS CoV-2 në Kosovë nga periudha 10 korrik – 09 gusht 2024, përkatësisht nga java njëzet e tetë (28)- java tridhjetë e dy (32) e vitit 2024.

Klasifikimi i varianteve shërben si një mjet i rëndësishëm komunikimi, për të paralajmëruar vendet për shfaqjen e varianteve të SARS-CoV-2 me veçori shqetësuese, e që mund të ndikojnë në situatën epidemiologjike. Edhe në laboratorin tone, përcjellja e situatës epidemiologjike me COVID-19 është orientuar drejt sekuencionimit dhe hulumtimit të varianteve eventuale të reja në qarkullim.

Përqindja e pozitivitetit të SARS-COV-2 në nivel rajonal vazhdon të bjerë ngadalë, por ka ndryshime midis vendeve dhe zonave. Grup moshat më të vjetra vazhdojnë të përbëjnë përqindjen më të lartë të rasteve. Aktiviteti i gripit dhe RSV mbetet i ulët.

SARS-CoV-2 ishte 10% krahasuar me 10% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit për 18 vende dhe zona ishte 8% (varg: 0%-24%). Në të gjithë rajonin, përqindja e të gjithë mostrave nga pacientët që paraqiten në qendrat e SARI-s sentinel që rezultuan pozitivë për SARS-CoV-2 ishte 13% krahasuar me 14% në javën e kaluar.

Midis javëve 40/2024 dhe 41/2024, 8 vende dhe zona raportuan informacion mjaft të plotë për të lejuar llogaritjen e frekuencës relative të varianteve specifike. Midis këtyre vendeve dhe zonave, përqindja mesatare (gama) e të gjitha izolimeve të sekuencave të virusit të zbuluara, që janë një variant aktual ose i mëparshëm shqetësimi ose variant interesi, ishte:

- PK.3: 60% (34%-73% nga 8 vende dhe zona).
- BA.2.86: 18% (6%-66% nga 8 vende dhe zona). Shënim: Izolat JN.1 përfshihen në BA.2.86.
- Variantet më të zakonshme SARS-CoV-2 në GISAID për Rajonin Evropian në tetor deri më tani ishin: KP.3.1.1 (41%); XEC (24%); KP.3.1 (9%); JN.1 (8%); JN.1.11 (4%); dhe JN.1.16 (3%) (n=1807).


***Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024.***

- ***53% për Variantin KP.3 (44 detektive)***
- ***47% për Variantin BA.2.86 (39 detektive).***

Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3.

Për më shumë detaje, gjeni të dhënat në tabelën e bashkangjitur:

### Variantet e SARS-CoV-2 në Kosovë, korrik-gusht, 2024



- Në periudhën (16.10.2024 – 22.10.2024) në Kosovë janë raportuar 2 raste (mesatarja 0.28 raste pozitive), Mb=0.11/100.000 banorë dhe asnjë rast të vdekjes me COVID-19.
- Në periudhën (23.10.2024 – 29.10.2024) në Kosovë është raportuar 1 rast (mesatarja 0.14 raste pozitive), Mb=0.05/100.000 banorë dhe 0 raste të vdekjes me COVID-19.
- Nëse krahasojmë këto periudha javore kemi rënie të lehtë të rasteve pozitive, si dhe me  $R_t=0.66$ .

### REKOMANDIME

Megjithëse aktiviteti SARS-CoV-2 mbetet i ngritur, ka pasur një tendencë rënëse në BE/EEA që nga piku në korrik, duke përfshirë shumicën e vendeve që përjetuan një epidemi gjatë verës. Epidemia e SARS-CoV-2 pranverë/verë ka çuar në një numër të konsiderueshëm rastesh, kryesisht të moshuar 65 vjeç e lart, duke u shtruar në spital, MIQ ose raste të vdekjes. Në shumicën e vendeve, nivelet e larta të sëmundjes nuk arritën ato të raportuara në sezonin e fundit gjatë dimrit. Të dhënat sugjerojnë se rastet 65 vjeç e lart me COVID-19 përbënin mbi një të katërtën e shtrimeve në spital në mesin e rasteve me simptoma respiratore për javën e 40-të. Varianti SARS-CoV-2 BA.2.86 dhe nënvariantet e tij, duke përfshirë KP.3, vazhdojnë të dominojnë në vendet e BE/ZEE.

Gjendja post-COVID-19 (PCC) vazhdon të përbëjë një barrë të konsiderueshme për sistemet shëndetësore. Është sfiduese të vlerësohet incidenca e PCC me saktësi të lartë, por të dhënat sugjerojnë se afërsisht 6% e rasteve simptomatike me SARS-CoV-2 rezultuan në simptoma të PCC. Ndërsa COVID-19 i rëndë është një faktor rreziku i rëndësishëm për PCC, mbi 90% e rasteve me PCC zhvillohen pas COVID-19 mesatar.

Vaksinimi është masa më efektive për t'u mbrojtur kundër formave më të rënda të COVID-19 dhe gripit sezonal. Meqenëse efekti mbrojtës zvogëlohet me kalimin e kohës, promovimi i vaksinimit kundër sëmundjeve virale të frymëmarrjes sipas rekomandimeve kombëtare përpara fillimit të sezonit të dimrit mbetet i rëndësishëm për të gjitha vendet e BE/ZEE, veçanërisht për të mbrojtur individët me rrezik më të lartë të sëmundjeve të rënda.

Në kuadër të mbikëqyrjes epidemiologjike të SARS-CoV-2 në Republikën e Kosovës dhe rekomandimeve të fundit të CDC dhe ECDC, rekomandojmë që:

1. Bazuar në situatën epidemiologjike aktuale në vend dhe në standardet e shteteve evropiane për parandalim dhe kontroll kundër COVID-19 (duke përcjell gjithnjë trendin e përhapjes së varianteve qarkulluese të SARS-CoV-2) rekomandojmë ngritje të vigjilencës nga ana e punëtorëve shëndetësorë me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe parandalimit të infeksioneve.
2. Të respektohet bartja e maskave dhe mjeteve tjera mbrojtëse si dhe reduktimi i vizitave të familjarëve në institucionet shëndetësore që merren me trajtimin e rasteve me COVID-19 dhe infeksione tjera me patogjenë respiratorë;
3. Rastet që rezultojnë pozitiv në SARS-CoV-2 rekomandohet që të izoloohen për 5 ditë, kurse kthimi në aktivitetet normale pune të bëhet sipas rekomandimit të mjekut/klinikistit;
4. Personat e kontaktit me personin e sëmurë të mos izoloohen por të përdorin masat për të parandaluar përhapjen e infeksionit, duke përfshirë përcjelljen e vazhdueshme të simptomave dhe distancimin larg të tjerëve, sidomos ndaj personave me sëmundje kronike dhe atyre të moshuar. Në rast se vërehen simptoma duhet të testohen në institucionin më të afërt shëndetësor.
5. Rekomandohet që të mos qëndrohet në ambiente të mbyllura, ku mundësia e infektimit është më e madhe;
6. Rekomandojmë vaksinimin e popullatës bazuar në Planin e Imunizimit, me theks të veçantë për grupet e rrezikut (personat me sëmundje kronike jongjtitëse, personat  $\geq 65$  vjeç etj). Megjithëse njerëzit e vaksinuar ndonjëherë infektohen me virusin që shkakton COVID-19, rivaksinimi me vaksinat kundër COVID-19 ul ndjeshëm rrezikun për format e rënda të sëmundjes, për shtrimet në spital ose për rastet me fatalitet nga COVID-19;
7. Të bëhet testimi i rasteve sipas definicionit të rastit dhe sipas rekomandimeve të mjekut/klinikistit, si dhe rastet pozitive të raportohen në IKShPK;
8. Rastet ambulantore dhe të hospitalizuara në ShSKUK, rekomandohet të analizohen nga ana e konziliumit të mjekëve përmes auditeve, në bashkërendim me kapacitetet e planifikuara të ShSKUK e që paraqet një indikatorë për zbatim rigoroz dhe respektim të masave në fuqi për të parandaluar variantet e reja të SARS-CoV-2. Meqenëse variantet e interesit kanë transmetueshmëri të lartë, personat e prekur mund të përfundojnë fatalisht nëse nuk kërkojnë me kohë ndihmë mjekësore dhe nuk ju përmbahen masave të parandalimit dhe kontrollit kundër COVID-19;
9. Të gjitha institucionet shëndetësore sipas Ligjit Nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse, të raportojë për çdo rast të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse (përfshirë edhe COVID-19) duke qenë me diagnozë të qartë;

10. Trajtimi i pacientëve me COVID-19 të bëhet sipas udhërrëfyesit klinik për menaxhimin dhe trajtimin e këtyre rasteve;
11. Të informohet popullata në vazhdimësi për të rejat dhe masat parandaluese rreth COVID-19.